

V E N D I M

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Xhezair ZAGANJORI	- Kryesues
Arjana FULLANI	- Anëtar
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Andi ÇELIKU	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

Asistuar nga sekretarja **Ermelinda Kadiu** sot me datë **02.05.2017** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative që iu përket palëve të mëposhtme:

PADITËS: **Mimoza Pitikoja**, e përfaqësuar në gjyq me prokurë të posaçme nga Av. Petraq Semani.

I PADITUR: **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** (Në mungesë).
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat (Në mungesë).

OBJEKTI: *Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, vendimit nr. 274, datë 01.04.2015 të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.*
Kthimin e paditëses Mimoza Pitikoja në vendin e mëparshëm të punës në detyrën Drejtore e Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat.
Pagimin e pagës nga data 01.04.2015 deri ditën e ekzekutimit të vendimit për kthimin në punë.
Sigurimin e padisë, pezullimin e zbatimit të aktit administrativ.

BAZA LIGJORE: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, KEDNJ, Kodi i Procedurës Administrative, ligji nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala për zbatim të tij, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala për zbatim të tij, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe Kodi i Procedurës Civile.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 821, datë 05.06.2015 ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2557, datë 27.11.2015 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 821, datë 05.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Pranimin e padisë.

Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 274, datë 01.04.2015 të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Kthimin e paditëses Mimoza Pitikoja në vendin e mëparshëm të punës në detyrën e Drejtores së Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ti paguaj paditëses Mimoza Pitikoja pagën nga data 01.04.2015 deri në ekzekutimin e vendimit.

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 2557, datë 27.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 821, datë 05.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

U shpall në Tiranë, me datë 02.05.2017

**Nr. 31001-00176-00-2016 Regj. Themeltar
Nr. 00 - 2017 - 546 Vendimi (333)**